



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0317

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë të POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender me numër të prokurimit 214/30400-25-11147-1-1-1, me 11/06/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K. me nr. 2026/0317, e datës 15/05/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender me numër të prokurimit 214/30400-25-11147-1-1-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të POLICIA E KOSOVËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender me numër të prokurimit 214/30400-25-11147-1-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.12.2025 POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-ne-Ritender” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11147-1-1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 243,000.00 €.

Me 28.04.2026. POLICIA E KOSOVËS duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kunder njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE "AGS Corporation dhe Auto Kacandolli.

Me 03.05.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 06.05.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 15.05.2026, OE KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoli 2026/0317, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Duke analizuar vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 06.05.2026, ne, OE Kosova Motors Group sh.p.k. (tutje: "KMG"), si operator ekonomik i cili e paraqet këtë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (tutje: "OSHP") kundër njoftimit të AK-së për dhënie të kontratës dhe kundër vendimit të AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 06.05.2026, konstatojmë se në këtë ankesë do t'i paraqesim në vijim pretendimet dhe dëshmitë tona që kanë të bëjnë lidhur me vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe rekomandimin e kundërligjshëm për dhënien e kontratës.

Shihet qartë se AK nuk i ka marrë për bazë fare argumentet tona të prezantuara në kërkesën për rishqyrtim të datës 30.04.2026, të cilat i gjeni të gjitha të bashkangjitura në lëndën e kësaj ankese, respektivisht në kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga ana jonë, e cila është refuzuar pa të drejtë nga AK. I njëjti nuk ka dhënë asnjë mendim shtesë, përpos se i ka bërë copy-paste arsyet e saj paraprake, të cilat vetëm se kanë qenë të paraqitura në raportin e vlerësimit, konkretisht në letrat standarde të datës 28.04.2026. Shikoni dëshminë në vijim, citoj:

Kjo shpie drejt shkeljes së Nenit 7 të LPP-së, sepse AK nuk ka bërë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Tutje, ju lutem na lejoni t'i parashtrojmë pretendimet tona se përse AK, edhe në vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka bërë shkelje flagrante të LPP-së duke refuzuar pa të drejtë ofertën tonë, e cila ofertë është e përgjegjshme, dhe duke mos marrë parasysh pretendimet tona apo faktet tona të prezantuara te AK se përse GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka qenë i

përgjegjshëm dhe se, në kundërshtim me Nenin 59 dhe 60 të LPP-së, AK e ka përzgjedhur si të përgjegjshëm GOE-në në fjalë.

Në vendimin e AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK pretendon si në vijim, citoj:

Në dosjen e ankesës e gjeni garancionin e prodhuesit dhe njëherësh e gjeni edhe shkresën zyrtare të datës 03.03.2026, me të cilën shkresë AK i drejtohet prodhuesit për konfirmim të vërtetësisë së dokumenteve dhe konfirmimin e validitetit dhe origjinalitetit të dokumenteve të lëshuara nga prodhuesi, i cili me po të njëjtën datë ia kthen zyrtarisht shkresën AK-së. (Bashkangjitur gjeni dokumentin e titulluar mail_001.zip).

AK ka vepruar njëjtë edhe me prodhuesin tonë MAN. Më datë 04.03.2026 dhe 06.03.2026 i drejtohet zyrtarisht për konfirmim të validitetit dhe origjinalitetit të dokumentacionit në fjalë dhe po të njëjtën ditë i kthehet AK-së e-maili zyrtar. (Bashkangjitur e gjeni dokumentin e titulluar mail_002.zip).

Prodhuesit e mjeteve motorike ofrojnë garancion me vite dhe kilometra, varësisht përdorimit të tyre. Në këtë rast, AK ka bërë shkelje të Nenit 7 të LPP-së, sepse nuk e ka marrë për bazë fare pretendimin tonë që jemi deklaruar se edhe GOE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tij e ka të njëjtin kriter, citoj:

Në web-faqen zyrtare të prodhuesit të OE ankues citohet si në vijim: "In addition to the 12 month warranty with unlimited mileage for the complete vehicle, the extended Mercedes-Benz Trucks warranty extends to 36 months for parts of the drivetrain. It affects parts groups in the engine, transmission, drive shaft(s) and drive axle(s) up to a maximum of 450,000 km depending on the type of use".

Kjo konfirmon se limiti i kilometrave në politikat e garancisë së tyre shkon deri në maksimum 450,000 km. Referojuni web-faqes zyrtare të prodhuesit Mercedes-Benz, ku pretendimi ynë i lartcekur vërtetohet. Këtë pretendim si dëshmi e gjeni edhe në katalogun e kompanisë ankuese, ku në vijim shihet qartë:

AK as nuk e ka komentuar fare këtë pretendim dhe, si rrjedhojë e kësaj, AK e ka shkelur Nenin 7 të LPP-së.

Prandaj, ne deklarojmë se e plotësojmë këtë kriter dhe se, në përputhje me Nenin 59 pika 2, AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarime shitesë nga ana jonë në lidhje me këtë çështje e jo të na diskualifikojë pa të drejtë nga pjesëmarrja, duke marrë parasysh këtu se kemi qenë OE i rekomanduar për kontratë derisa GOE ankues bëri kërkesë për rivlerësim, e cila çuditërisht iu aprovua, marrë parasysh se me çmim janë më të lartë se oferta jonë e përgjegjshme.

Sa i përket çështjes së tahografit, jemi deklaruar se e plotësojmë këtë kriter me përpikëri dhe do ta liferojmë produktin në përputhje të plotë me specifikimet teknike.

Po ashtu, sa i përket pretendimit për dritën rotative, siç edhe jemi deklaruar, e njëjta përputhet në përpikëri me specifikimet teknike. Ju lutem referojuni katalogut tonë dhe kërkesës për rishqyrtim, ku i gjeni të gjitha informatat në lidhje me këtë çështje, sepse dëshirojmë të mënjanojmë reprizat apo përsëritjet e deklaratave, të cilave u qëndrojmë prapa me ato të përmendura në dokumentet e lartcekura.

Në vendimin mbi refuzim, Pretendimi 1, citoj:

Për fund:

I lutemi OSHP-së që ta vlerësojë ankesën tonë, ta trajtojë me kujdes dhe të njëjtën ta kualifikojë si të bazuar, të obligohet AK që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe, në përputhje me Nenin 1 dhe 7 të LPP-së, të marrë vendim të duhur dhe korrekt dhe jo të bjerë pre e pretendimeve të ulëta, joprofesionale dhe, mbi të gjitha, jo korrekte të GOE-së, i cili vetëm tenton të bëjë çmos që të mënjanohet kriteri i dhënies së kontratës për ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët dhe kështu të manifestojë me lloj-lloj veprimesh vetëm që të arrijë qëllimet e veta, të cilat ne i konsiderojmë veprime shumë të ulëta dhe veprime për keqardhje!

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

- AK nuk ka shkelur Nenin 1 – Qëllimi i LPP-së, sepse autoriteti kontraktues ka respektuar në tërësi qëllimin e këtij ligji, që është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, dhe ka siguruar integritet dhe përgjegjësi të zyrtarëve përgjegjës, transparencë dhe mosdiskriminim.
- AK nuk e ka shkelur Nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, pasi të gjithë OE janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe specifikave teknike. Po ashtu, AK nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE përmes kësaj procedure, prandaj nuk qëndron pretendimi.
- AK nuk ka shkelur Nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve të LPP-së. Autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e tenderit në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara me njoftimin për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme, Aneksi I. Andaj, AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjitha ofertave në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.
- AK nuk e ka shkelur Nenin 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Pretendimet për shkelje të Nenit 60 të LPP-së, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që është zbatuar me përpikëri të plotë ky nen, pasi që është rekomanduar për kontratë oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët, ndërsa oferta juaj është refuzuar për arsyt si në vijim:

OE ka dështuar në kriterin si në vijim:

Në DT dhe Njoftimin për Kontratë është kërkuar si në vijim:

Kërkesa I – Garancion nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit mbi garancionin, i cili duhet të jetë prej minimum 24 muaj nga data e pranimit final të furnizimeve.

OE ka sjellë deklaratë në kundërshtim me kriterin e AK-së, ku ka ofruar 24 muaj / 150.000 km.

Andaj, ky kushtëzim është i papranueshëm.

OE gjithashtu ka dështuar në Aneksin I të DT-së, si në vijim:

Në Aneks është kërkuar: drita rotative mbi kabinë (komplet gjerësia e kabinës). OE ka sjellë automjetin me 2 drita rotative (anësore të kabinës dhe jo në gjerësi të kabinës).

OE gjithashtu ka dështuar në Aneksin I të DT-së, si në pozicionin 11 të specifikacioneve teknike: Elektrik me disk fleta 24-orëshe.

OE ka ofruar si në vijim:

Tachograph, digital, with telecommunication (as per DSRC), CONTINENTAL OP5DV.

Tahografi i cili është ofruar është në kundërshtim me kërkesën e AK-së, sepse OE ka ofruar tahograf digjital dhe jo tahograf analog me 24 fleta.

Andaj, OE është i papërgjegjshëm për arsyet më lart dhe oferta i refuzohet.

Arsyet më lart janë të paraqitura në Raportin e Vlerësimit dhe Letrat Standarde të datës 28.04.2026. Prandaj, ky pretendim i OE-së është i pabazuar.

- Pretendimi I – OE ankues pretendon që katalogu i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prejardhje nga prodhuesi.

Komisioni i vlerësimit ka bërë verifikimin e dokumenteve, autorizimeve, garancionit dhe katalogëve nga personat e autorizuar, për të cilat ne kemi konfirmim që të gjitha janë autentike dhe të vlefshme. Andaj, kjo nuk qëndron.

- Pretendimi 2 – OE ankues pretendon që OE i rekomanduar nuk e ka dëshmuar:

Sistemi i drejtimit: Servo hidraulik – timoni në anën e majtë.

Pretendon që timoni i ofruar në katalog është elektrik.

C61 Power steering hydraulic pump, controlled.

Power steering nuk nënkupton sistem drejtimi elektronik.

Power (në përkthim nga anglishtja – fuqi).

Andaj, është pompë hidraulike dhe jo elektronike, prandaj pretendimi nuk qëndron.

- Pretendimi 3 – OE ankues që MAK AUTOSTAR DOEL ka autorizim deri më 31 dhjetor 2026, është dokument jorelevant dhe nuk ka qenë kriter kualifikues, dhe dokumentet të cilat nuk janë kualifikuese nuk merren parasysh. Megjithatë, kjo është një blerje dhe kontratë e cila do të përfundojë me dorëzimin e mallit (180 ditë).

Po e përsërisim që komisioni vlerësues ka verifikuar të gjitha dokumentet kualifikuese.

AK ka vlerësuar të gjitha kriteret dhe Aneksin I të DT-së dhe ka paraqitur të gjitha dëshmitë sipas dokumenteve relevante dhe qëndrojmë me vendimin e ngarkuar të datës 28.04.2026.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 15.05.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0317 ndërsa me datë 25.05.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0317, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit

shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjegjës për rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0317 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti, në pajtim me legjislacionin në fuqi, ka analizuar të gjitha pretendimet e ngritura nga OE ankues dhe vlerëson se OE ankues fillimisht ka ngritur çështjet për eliminimin e ofertës së tij nga procedura dhe pastaj ka ngritur 3 pretendime për OE të rekomanduar.

Eksperti shqyrtues fillimisht ka shqyrtuar dhe paraqitur pretendimet në lidhje me çështjet e eliminimit të OE ankues si më poshtë:

Pretendimi ankimor për Deklaratën e Garancionit

OE në këtë pretendim ankimor nuk është pajtuar me vlerësimin e AK-së sa i përket kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional, Kërkesa 1, në lidhje me garancionin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. OE ka deklaruar se AK ka bërë vlerësim jo korrekt dhe të pabazuar pasi që e ka eliminuar OE për arsye se OE ka ofruar deklaratë në kundërshtim me kriterin e AK-së, ku ka ofruar garancion 24 muaj/150.000 km. OE ankues pretendon se ka ofruar deklaratën për garancion 24 muaj, duke dhënë edhe sqarimet që janë cekur edhe në pikën ankimore.

OE ankues në të njëjtin pretendim deklaroi se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, duke cekur se OE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tij e ka të njëjtin kriter, duke cituar përshkrimin e ueb-faqes zyrtare të prodhuesit.

Përgjigje nga eksperti shqyrtues

Eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe pretendimin ankimor për deklaratën e garancionit, si dhe dokumentet e ofrura nga OE ankues dhe OE i rekomanduar për kontratë.

Kërkesa sipas FDT:

Kërkesa 1: Garancion nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit mbi garancionin, i cili duhet të jetë prej minimum 24 muaj nga data e pranimit final të furnizimeve.

Dëshmi 1: Deklaratë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i prodhuesit për garancion minimum 24 muaj.

OE ankues për këtë kërkesë ka ofruar dëshminë “Deklaratë Garancioni” të datës 9 shkurt 2026, në të cilën ceket se garancioni vlen për periudhën 24 muaj dhe 150.000 km, varësisht se cila konsumohet e para.

Dëshmi:

Pavarësisht që OE ankues ka ofruar sqarimet se në një dokument tjetër të dosjes së tenderit, që është “Letër Autorizimi”, përshkruhet garancion prej 24 muajsh, eksperti shqyrtues vlerëson se deklarimi i dhënë në “Deklaratën për Garancion” prej 24 muaj apo 150.000 km (varësisht se cila konsumohet e para) është në kundërshtim me Kërkesën numër 1 të nenit 9.1 & 9.2 - Kapaciteti teknik dhe profesional të FDT-së, pasi që kërkesa e dosjes së tenderit ishte vetëm për 24 muaj dhe nuk është kërkuar fare kufizim në km.

Sa i përket pretendimit që edhe OE i rekomanduar e ka deklaruar të njëjtin kriter, kjo nuk qëndron sepse në deklaratën për garancion, e cila është kërkesë e FDT-së, OE i rekomanduar ka ofruar garancion prej 24 muajsh pa dhënë kufizime tjera shtesë.

Dëshmi:

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi ankimor për Tahografin dhe Dritën Rotative

OE në vazhdim ka deklaruar edhe dy çështje për të cilat është eliminuar oferta e tij, që kanë të bëjnë me tahografin dhe dritën rotative, duke deklaruar që çështjen e tahografit e plotëson kriterin me përpikëri dhe do ta liferojë produktin në përputhje të plotë me specifikimet teknike.

Po ashtu, OE ankues ka shfaqur edhe pretendimin për dritën rotative, ku është deklaruar se e njëjta përputhet në përpikëri me specifikimet teknike, duke theksuar që t’i referohen katalogut për të vërtetuar përputhshmërinë e tyre.

Përgjigje nga eksperti shqyrtues

Eksperti shqyrtues ka analizuar çështjet e ngritura nga OE ankues sa i përket tahografit dhe dritës rotative, duke analizuar edhe kërkesën në Specifikimet Teknike (ST) sipas Aneksit 1 të DT-së.

Në ST, lidhur me këto dy kërkesa, AK ka kërkuar që:

Pika 11: Tahografi elektrik me disk, fleta 24-orëshe, dhe ndër të tjera;

Pajisjet standarde minimale: drita rotative mbi kabinë (komplet gjerësia e kabinës).

Në bazë të ST-së dhe katalogut të ofruar nga OE ankues, si dhe sqarimeve të dhëna nga OE, eksperti vlerëson se përshkrimi për tahografin në katalogun e ofruar nuk përputhet me përshkrimin e kërkuar në dosjen e tenderit.

Specifikimi sipas katalogut të ofruar nga OE ankues:

Tachograph, digital, with telecommunication (as per DSRC), CONTINENTAL 0P5DV

Gjithashtu, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar edhe çështjen e dritës rotative dhe sqarimet e dhëna nga OE, për të cilën vlerëson se, në bazë të katalogut të ofruar nga OE ankues, përshkrimi për dritën rotative është në pajtim me kërkesën e ST-së në dosjen e tenderit.

Specifikimi sipas katalogut të ofruar nga OE ankues:

Hazard warning light, 1 unit, with continuous light function 0P3FF

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi për çështjen e tahografit është i pabazuar, ndërsa sa i përket dritës rotative pretendimi është i bazuar.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues në pretendimet ankimore ndaj OE të rekomanduar

Pretendimi ankimor 1 ndaj OE të rekomanduar

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 - Kërkesa 2: Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilin është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.

Dëshmi 2: Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilin është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.

OE ankues ka pretenduar që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar katalogun nga prodhuesi, siç është kërkuar në dosjen e tenderit. OE ankues në këtë rast ka paraqitur dëshmi se katalogu i ofruar është i hartuar nga vetë ofertuesi e jo nga prodhuesi.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, pavarësisht marrëveshjeve dhe autorizimeve të paraqitura, nuk është katalog i lëshuar nga prodhuesi. Meqenëse dosja e tenderit ka kërkuar në mënyrë të qartë “Katalog nga prodhuesi”, dokumenti i ofruar nuk është katalog nga prodhuesi, por është një dokument alternativ i hartuar nga vetë ofertuesi.

Eksperti shqyrtues sqaron se në këtë rast mungon “Katalogu nga prodhuesi”, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 002/2024 (neni 10), për sqarimin e tenderëve gjatë vlerësimit, autoriteti kontraktues ka të drejtë që gjatë fazës së vlerësimit të kërkojë informata sqaruese në rastet kur mungon katalogu.

Prandaj, çështja mund të trajtohet në rivlerësim duke kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar dhe të kërkojnë informata sqaruese konform Udhëzimit Administrativ.

Pretendimi ankimor 2 ndaj OE të rekomanduar

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk e ka ofruar sistemin e drejtimit sipas kërkesës së dosjes së tenderit: “Sistemi i drejtimit: Servo hidraulik - timoni në të majtë”, por në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë është paraqitur sistemi i drejtimit “Power steering Hydraulic pump, controlled”. Sipas OE ankues, ky lloj sistemi është sistem drejtimi elektronik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Eksperti shqyrtues, pas analizës teknike dhe konsultimeve profesionale, si dhe burimeve relevante të siguruar nga publikime të ndryshme që e sqarojnë këtë sistem drejtimi, ka vlerësuar se sistemi “Power steering Hydraulic pump, controlled” është një sistem drejtimi me asistim hidraulik (servo hidraulik). Në këtë kuptim, ai konsideron se sistemi i ofruar është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 2 është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3 ndaj OE të rekomanduar

OE ankues e ka kontestuar letrën e konfirmimit zyrtar të lëshuar nga prodhuesi Mercedes-Benz në drejtim të distributorit të saj në Maqedoni, ku ndër të tjera konfirmohet se validiteti i saj është i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2026. OE e ka kontestuar dokumentin për shkak të validitetit të dokumentit, i cili nuk përfshin periudhën prej 36 muajsh.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin ankimor si dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Në lidhje me këtë pretendim, eksperti konsideron se kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Ndërsa sa i përket palëve të treta, AK nuk mund të paragjykojë marrëdhëniet kontraktuale mes tyre. Eksperti shqyrtues konfirmon se në momentin e ofertimit marrëveshjet e paraqitura kanë vlefshmëri.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 3 është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-ne-Ritender” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11147-1-1-1"

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj ja fal besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues, pa nevoj që të njëjtat të përsëriten sërish, se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: